

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS-VLADA KOSOVA-GOVERNMENT OF KOSOVO
MINISTRIA E SHËNDETËSISË-MINISTARSTVO ZDRAVLJA-MINISTRY OF HEALTH

Njësia Org.
Org.Jedinica
Org Unit 02

Nr. Prot:
Broj Prot:
Prot.No: 05-4568

Data:
Datum: 02,09,2019

Nr. i faqeve
Br.stranica
No. pages -4-

Prishtinë / a



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO

FONDI I SIGURIMIT SHËNDETËSOR FOND ZA ZDRAVSTVENO OSIGURANJE
HEALTH INSURANCE FUND

Njësia Org.
Org. Jedinica
Org. Unit FSSH

Nr. Prot.
Broj Prot.
Prot. No. 1899

Nr. i faqeve
Br.stranica
No. pages -4-

Data
Datum
Date 02,09,2019

PRISHTINË - PRISHTINA - PRISTINA

Republika e Kosovës

Republika Kosovo – Republic of Kosovo

Qeveria – Vlada – Government

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

ndërmjet

MINISTRISË SË SHËNDETËSISË

dhe

FONDIT TË SIGURIMEVE SHËNDETËSORE

Ministria e Shëndetësisë (në tekstin e mëtejshëm "MSh") dhe Fondi i Sigurimeve Shëndetësore (në tekstin e mëtejshëm: "FSSh") janë dakorduar për këtë Marrëveshje Bashkëpunimi (në tekstin e mëtejshëm 'Marrëveshja').

Neni 1

Qëllimi

Qëllimi i kësaj Marrëveshje është të lehtësojë bashkëpunimin në mes të palëve në çështjet me interes të përbashkët dhe me theks të veçantë në shkëmbimin e të dhënave ndërmjet Sistemit Informativ Shëndetësor (SISh) dhe Sistemit Informativ të Fondit (SIF), meqenëse sipas dispozitave ligjore në fuqi FSSh-ja ka qasje në të dhënat përkitazi me shërbimet shëndetësore të grumbulluara në SISh, të nevojshme për ushtrimin e veprimtarisë së tij ligjore, të përcaktuar me ligjin bazik të shëndetësisë.

Neni 2

Përdorimi i të dhënave

- 2.1 Përdorimi i të dhënave do të mundësohet përmes leximit të tyre (marrjes) përmes Ueb Shërbimeve (ose Ueb API-ve) dhe do të jenë te qasshëm vetëm nga përdorues të autorizuar.
- 2.2 Palët hartojnë udhëzues (procedura standarde të operimit), që është pjesë përbërëse e kësaj Marrëveshjeje Bashkëpunimi, për shkëmbimin e të dhënave përmes të cilëve do të definohen të dhënat të cilat do të shkëmbehen në nivel teknik.

Neni 3

Zotimet e palëve

- 3.1. Palët pranojnë se ekzekutimi i suksesshëm i Marrëveshjes është/varet nga qeverisja dhe marrëdhënia adekuate dhe e përshtatshme e menaxhimit.
- 3.2. Për çdo Marrëveshje të ndarjes së të dhënave që ndërmerren, Palët bien dakord të emërojnë përfaqësuesit e duhur të secilës Palë për të siguruar efikasitet dhe efektivitet qeverisjen dhe funksionimin e kësaj Marrëveshjeje për Ndarjen e të Dhënave. Stafit i emëruar në grupet e tilla do të kenë aftësitë dhe skipet e mjaftueshme për t'u mundësuar atyre shkarkojnë përgjegjësitë e tyre.
- 3.3. Palët sigurojnë teknologjinë e duhur që do të shfrytëzohet si urë lidhëse ndërmjet sistemeve.

- 3.4. Palët mbajnë resurset në gjendje të qasshme dhe të përditësuar.
- 3.5. Palët pajtohen që të dhënat të cilat do të shfrytëzohen nga zyrtarët e saj janë konfidenciale dhe si të tilla do të përdoren vetëm për qëllime të këtij memorandumi dhe të njëjtat do të përdoren vetëm nga zyrtarët e autorizuar.

Neni 4

Ndarja e shpenzimeve

Palët bien dakord që të gjitha shpenzimet e bëra në lidhje me këtë marrëveshje, do të jenë përgjegjësinë e secilës palë. Kur palët bien dakord të ndajnë shpenzimet në lidhje me aktivitetet e iniciuara sipas kësaj marrëveshje, do të përcaktohen nëpërmjet një marrëveshjeje të veçantë kontraktuale.

Neni 5

Mbrojtja e të dhënave personale

Përpunimi dhe përdorimi i të dhënave personale nga kjo marrëveshje duhet të bëhet në pajtim me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

Neni 6

Afati dhe amandamentimi

- 6.1 Kjo marrëveshje bashkëpunimi ka afat 3 vite.
- 6.2 Kjo marrëveshje mund të ndryshohet vetëm me dakordim të ndërsjellë të palëve. Palët mundën të ndryshojnë ndonjë nga dispozitat e kësaj marrëveshje ose të hyjnë në aranzhime plotësuese të disenjuara për të përcaktuar më tej fushëveprimin e saj.

Neni 7

Marrëdhëniet e palëve

Për qëllimet e këtij Memorandumi asnjëra palë nuk do të ketë autorizime për të bërë ndonjë deklaratë, përfaqësim ose angazhim të çfarëdo lloji, ose për të ndërmarrë ndonjë veprim i cili do të jetë detyrues për palën tjetër, me përjashtim të rasteve kur parashikohet shprehimisht në këtë Marrëveshje ose të autorizuar me shkrim nga pala tjetër.

Neni 8

Përgjegjësia

Secila Palë do të jetë përgjegjëse vetëm për mënyrën në të cilën ajo kryen pjesë të aktiviteteve të bashkëpunimit në bazë të kësaj Marrëveshje dhe / ose ndonjë marrëveshje tjetër. Kështu që, asnjëra Palë nuk do të jetë përgjegjëse për ndonjë humbje, aksident, dëmtim i cili është shkaktuar ose e ka shkaktuar Pala tjetër, ose nga punonjësit, konsulentët ose nën-kontraktorët e palës tjetër, në lidhje me ose si rezultat i bashkëpunimit për realizimin e aktiviteteve sipas kësaj Marrëveshje

Neni 9

Hyrja në fuqi

- 9.1 Palët pajtohen që kjo Marrëveshje fillon së zbatuari në ditën e nënshkrimit nga Palët.
- 9.2 Kjo Marrëveshje nënshkruhet në dy (2) kopje origjinale dhe me nënshkrimin e saj, palët obligohen në zbatimin e plotë.

Për:

Ministrinë e Shëndetësisë

Dr. Naim Bardhi

Sekretar i Përgjithshëm




Për:

Fondin e Sigurimeve Shëndetësore

Fatmir Plaqiqi

Drejtor i Fondit



Prishtinë,
22 gusht 2019